

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **SKUPSTINA OPSTINA GRACANICA**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **618-26-2899-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Shërbimet e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit të objekteve, institucioneve dhe hapësirave publike në Komunën e Graçanicës**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>Vector Pest Control SH.P.K.</b>
NUI	<b>810186652</b>
Adresa	<b>Gelanc</b>
Vendi	<b>Suhakrek</b>
Kodi postar	<b>23 000</b>
Numri Telefonit	<b>049300199</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Aglir Delijaj</b>
Adresa elektronike	<b>info@vector-pestcontrol.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>05.07.2026</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Shërbimet e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit të objekteve, institucioneve dhe hapësirave publike në Komunën e Graçanicës**

**Komuna e Graçanicës ne cilesi te Autoritetit Kontraktues ka inicuar proceduren e lartshenuar te prokurimit. Ne si pale me interes per kete aktivitet, kemi marre pjese dhe kemi dorezuar oferten me te lire te pergjegjeshme. AK permes formularit B58 Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, na ka eliminuar oferten tone me te liren me pretendime dhe kriteret qe nuk kan qene ne Dosje te Tenderit dhe Njoftim per Kontrate. Duke ditur faktin qe ishim oferta me e lire e pergjegjeshme, ne mbeshtetje te Ligjit te Prokurimit dhe Rregulloreve ne fuqi, brenda afatit ligjor kemi dorezuar permes platformes E prokurimi Kerkese per Rishqyrtim, si pale e pakenaqur me Vendimin e Ak-se, duke i argumentuar dhe hedhur poshte pretendimet e AK-se per eliminimin tone. AK, ka marre vendim per refuzim te kerkeses tone, duke tentuar te shtojte kriteret, te tentoj me cdo forme te na paraqes si oferte e papergjegjeshme. Mbeshtetur ne Ligjin per Prokurim Publik, brenda afatit ligjor po dorezojm Ankesa ne OSHP.**

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

**Permes platformes E prokurimi.**

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

**Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën tone, me crast si pale e pakenaqur po**

## **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

- neni 1 i LPP-së (qëllimi i ligjit);
- neni 7 i LPP-së (trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi);
- neni 56 i LPP-së;
- neni 59 i LPP-së;
- neni 69 i LPP-së;
- neni 72 i LPP-së;
- neni 26.5 i Rregullores për Prokurimin Publik;

Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar kriteret e shkruara në Dosjen e Tenderit, por ka ndërtuar kriteret e reja gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, duke cenuar sigurinë juridike të operatorëve ekonomikë dhe parimin e transparencës. Vlerësimi është mbështetur në interpretime subjektive dhe jo në kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, çka përbën shkelje të drejtpërdrejtë të dispozitave të sipërcituara.

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Kjo ankesë parashtrohet kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, Komuna e Graçanicës, me të cilin është eliminuar oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomikë Vector Pest Control SH.P.K. dhe Jusuf Berisha B.I., si dhe kundër vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Vendimi i Autoritetit Kontraktues është marrë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, Rregulloren për Prokurimin Publik dhe parimet themelore të transparencës, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit, për arsye se:

- Autoriteti Kontraktues ka interpretuar kriteret e Dosjes së Tenderit në mënyrë arbitrare;
- ka aplikuar kriteret që nuk janë kërkuar në Dosjen e Tenderit;
- ka krijuar kërkesa të reja pas hapjes së ofertave;

- nuk ka zbatuar dispozitat e LPP-së dhe Rregullores për Prokurimin Publik lidhur me sqarimin dhe verifikimin e dokumentacionit;
- ka bërë konkluzione teknike pa u mbështetur në ekspertizë profesionale dhe pa iu referuar ndonjë standardi apo dispozite ligjore.

Për më tepër, oferta e GOE është oferta me çmimin më të ulët në këtë procedurë, ndërsa eliminimi është mbështetur në interpretime subjektive dhe jo në kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Nga analiza e plotë e vendimit rezulton se pothuajse çdo arsye e eliminimit bazohet ose në kriteret që nuk ekzistojnë në dokumentacionin e tenderit, ose në interpretime personale të komisionit vlerësues, të cilat bien ndesh me nenin 40.12 dhe nenin 45.24 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Për rrjedhojë, vendimi i Autoritetit Kontraktues është i kundërligjshëm dhe duhet të anulohet.

Para se të trajtohen veçmas pretendimet e Autoritetit Kontraktues, është e rëndësishme të theksohet se vendimi për eliminim nuk është rezultat i një vlerësimi objektiv të dokumentacionit të dorëzuar, por i një qasjeje selektive dhe arbitrare.

Në pothuajse të gjitha pikat e vendimit, Autoriteti Kontraktues nuk konstaton mungesën e dokumenteve të kërkuara, por pretendon se dokumentet e dorëzuara nuk janë "të mjaftueshme", "nuk janë të besueshme", "nuk janë adekuate", "nuk janë të avancuara", "nuk dëshmojnë", apo "nuk përmbajnë" elemente që nuk janë kërkuar askund në Dosjen e Tenderit.

Ky dallim është thelbësor.

Dosja e Tenderit ka përcaktuar qartë dokumentet që operatorët ekonomikë kanë qenë të obliguar të dorëzojnë. GOE ka dorëzuar dokumentet e kërkuara. Megjithatë, gjatë vlerësimit, Autoriteti Kontraktues ka shtuar standarde të reja dhe ka bërë interpretime që nuk burojnë nga dokumentacioni i tenderit.

Një qasje e tillë bie ndesh drejtpërdrejt me nenin 40.12 dhe nenin 45.24 të Rregullores për Prokurimin Publik, sipas të cilave një operator ekonomik nuk mund të eliminohet mbi bazën e një kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës ose në Dosjen e Tenderit.

***Lidhur me pretendimin e Autoritetit Kontraktues se certifikata EN 16636:2015 nuk plotëson kërkesat e Dosjes së Tenderit***

Autoriteti Kontraktues ka pretenduar se GOE nuk e plotëson kriterin teknik lidhur me certifikatën EN 16636:2015, me arsyetimin se certifikata e paraqitur nuk përmban shprehjen "**kontrolli i zogjve dhe gjarpërinjve**", ndonëse sipas Autoritetit Kontraktues kjo ka qenë pjesë e kërkesës së Dosjes së Tenderit.

Ky konstatim është juridikisht dhe teknikisht i pabazuar.

Në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar vetëm:

**EN 16636:2015 (Shërbimet e Dezinfektimit, Dezinsektimit, Deratizimit, kontrolli i zogjve dhe gjarpërinjve).**

Nga kjo kërkesë nuk rezulton në asnjë mënyrë se operatorët ekonomikë kanë qenë të obliguar të paraqesin një certifikatë me formulim identik apo me përshkrim të njëjtë gjuhësor.

EN 16636:2015 është një **standard evropian** që përcakton kërkesat dhe kompetencat për ofrimin e shërbimeve profesionale të menaxhimit të dëmtuesve (Pest Management Services). Standardi nuk përcakton një model unik të certifikatës, nuk përcakton formulimin tekstual që duhet të përdoret në certifikatë dhe as nuk obligon organet certifikuese të përdorin të njëjtin përshkrim të fushëveprimit.

Në praktikë, secili organ certifikues përdor formatin dhe terminologjinë e vet, përderisa certifikimi mbështetet në standardin EN 16636:2015.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues ka bërë një interpretim arbitrar duke e identifikuar përmbushjen e kriterit vetëm mbi bazën e formulimit tekstual të certifikatës dhe jo mbi bazën e standardit përkatës.

Edhe më problematik është fakti se Autoriteti Kontraktues nuk i referohet asnjë dokumenti teknik, asnjë interpretimi zyrtar të standardit EN 16636:2015, asnjë udhëzimi të CEN-it, CEPA-s apo ndonjë organi kompetent të akreditimit që do të mbështeste pretendimin e tij.

Në mungesë të një baze teknike ose ligjore, Autoriteti Kontraktues ka zëvendësuar standardin ndërkombëtar me interpretimin e vet subjektiv, gjë që nuk lejohet në procedurat e prokurimit publik.

Për më tepër, nga verifikimet e kryera nga ana e GOE rezulton se certifikata EN 16636:2015 e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë është lëshuar nga një subjekt për të cilin ekzistojnë dyshime serioze lidhur me kompetencën dhe akreditimin për certifikimin sipas këtij standardi. Pikërisht për këtë arsye GOE i është drejtuar institucionit përkatës me kërkesë zyrtare për verifikimin e vlefshmërisë së certifikatës, statusit të akreditimit dhe njohjes së saj në kuadër të skemës evropiane të certifikimit EN 16636:2015.

Nëse nga përgjigjja e institucionit kompetent rezulton se organi certifikues nuk posedon akreditim për certifikimin sipas EN 16636:2015, atëherë kjo do të nënkuptonte se Autoriteti Kontraktues ka refuzuar ofertën e GOE për shkak të një interpretimi arbitrar të certifikatës sonë, ndërkohë që ka pranuar certifikatën e operatorit tjetër pa verifikuar

vlefshmërinë dhe bazën e saj ligjore.

Një qasje e tillë cenon drejtpërdrejt parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, të përcaktuar në nenin 7 të LPP-së.

Për më tepër, edhe në rast se Autoriteti Kontraktues ka pasur dyshime lidhur me përmbajtjen ose fushëveprimin e certifikatës së paraqitur nga GOE, ai ka qenë i obliguar të zbatojë mekanizmat e paraparë në nenin 72 të LPP-së dhe nenin 40.8 të Rregullores për Prokurimin Publik, duke kërkuar sqarime ose duke verifikuar informacionin pranë organit certifikues, e jo të nxjerrë përfundime teknike të pambështetura.

Prandaj, pretendimi i Autoritetit Kontraktues në këtë pikë është i pabazuar në kërkesat e Dosjes së Tenderit, nuk mbështetet në ndonjë dispozitë ligjore apo standard teknik dhe, si i tillë, nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për eliminimin e ofertës së GOE.

### ***Lidhur me pretendimin se GOE nuk e ka përmbushur kriterin për referencat në vlerë prej së paku 300,000.00 €***

Autoriteti Kontraktues ka pretenduar se GOE nuk e plotëson kriterin e kërkuar lidhur me referencat, me arsyetimin se gjatë llogaritjes së kontratave të realizuara ka marrë në konsideratë vetëm pjesën proporcionale që, sipas vlerësimit të tij, i takon secilit anëtar të konsorciumit, duke zbritur vlerën e kontratave të realizuara në bashkëpunim me operatorë të tjerë ekonomikë.

Ky pretendim është në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, me Rregulloren për Prokurimin Publik, si dhe me vetë kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar:

**"Referenca e kërkuar për projektet e DDD duhet të jenë në vlerë prej jo më pak se 300,000.00 € të lëmisë së kërkuar për periudhën e tri viteve të fundit."**

Në asnjë pjesë të kësaj kërkesë nuk është përcaktuar se, në rastet kur kontratat janë realizuar nga një grup operatorësh ekonomikë apo konsorcium, do të merret në konsideratë vetëm një pjesë proporcionale e vlerës së kontratës.

Autoriteti Kontraktues ka krijuar këtë kriter vetëm gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, pa pasur asnjë bazë në dokumentacionin e tenderit.

Për më tepër, neni 26.5 i Rregullores për Prokurimin Publik përcakton qartë se:

**"Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 69 të LPP-së (aftësia teknike dhe profesionale), do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë."**

Kjo dispozitë nuk lë hapësirë për interpretim.

Legjislacioni i prokurimit publik e njeh grupin e operatorëve ekonomikë si një subjekt të vetëm për qëllime të vlerësimit të kapaciteteve teknike dhe profesionale.

Prandaj, edhe referencat duhet të vlerësohen në nivel të grupit dhe jo duke u copëzuar sipas një formule që nuk është paraparë askund në Dosjen e Tenderit.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se referencat e realizuara në kuadër të një konsorciumi duhet të llogariten vetëm në mënyrë proporcionale, ai ka qenë i obliguar që një kërkesë të tillë ta përfshinte shprehimisht në Dosjen e Tenderit para publikimit të procedurës.

Mosparashikimi i një kërkesë të tillë dhe aplikimi i saj vetëm pas hapjes së ofertave përbën ndryshim të rregullave të garës dhe cenon rëndë parimet e transparencës, sigurisë juridike dhe trajtimit të barabartë.

Për më tepër, kontratat e paraqitura nga GOE janë kontrata të realizuara me sukses, të pranuar nga autoritetet kontraktuese përkatëse dhe të shoqëruara me referenca përkatëse. Asnjë autoritet kontraktues nuk ka vënë në dyshim realizimin e tyre, ndërsa vetë fakti që një kontratë është realizuar në kuadër të një konsorciumi nuk e zbeh përvojën profesionale të operatorit ekonomik që ka qenë pjesë e saj.

Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar asnjë dispozitë ligjore apo ndonjë kërkesë të Dosjes së Tenderit që do ta autorizonte të bëjë ndarjen proporcionale të vlerës së kontratave.

Përkundrazi, ai ka ndërtuar një metodologji të re të vlerësimit gjatë fazës së ekzaminimit të ofertave, e cila nuk është bërë e njohur për operatorët ekonomikë para dorëzimit të ofertave.

Një veprim i tillë bie drejtpërdrejt në kundërshtim me nenin 40.12 dhe nenin 45.24 të Rregullores për Prokurimin Publik, sipas të cilave një operator ekonomik nuk mund të eliminohet mbi bazën e një kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës ose në Dosjen e Tenderit.

Për këto arsye, pretendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me mosplotësimin e kriterit për referencat është i pabazuar dhe nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për eliminimin e ofertës së GOE.

***Lidhur me pretendimin se certifikatat për Menaxhimin e Integruar të Dëmtuesve (Integrated Pest Management – IPM) nuk janë "në shërbim të D.D.D."***

Autoriteti Kontraktues ka pretenduar se GOE nuk e plotëson kërkesën për pesë (5) teknika

të trajnuar në menaxhimin e integruar të dëmtuesve (IPM), me arsyetimin se certifikatat e paraqitura nuk janë "në shërbim të D.D.D.", por kanë të bëjnë me bujqësinë, agronominë ose sigurinë në përdorimin e pesticideve.

Ky pretendim nuk mbështetet as në Dosjen e Tenderit dhe as në ndonjë dispozitë të Ligjit për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kërkuar vetëm:

**"Pesë (5) teknike në shërbim të D.D.D. të trajnuar në menaxhimin e integruar të dëmtuesve."**

Ndërsa si dëshmi dokumentare ka kërkuar vetëm:

- diplomë ose certifikatë;
- kontratë pune ose marrëveshje për projekt.

Në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit nuk është kërkuar që:

- certifikata të jetë e lëshuar vetëm nga një institucion i caktuar;
- certifikata të jetë e akredituar sipas një skeme të caktuar;
- certifikata të jetë trajnim fizik dhe jo online;
- certifikata të jetë vetëm për D.D.D. dhe jo për Integrated Pest Management;
- certifikata të ketë një program të caktuar mësimor;
- certifikata të ketë numër minimal orësh apo kreditesh;
- certifikata të mos përfshijë aplikime në sektorin bujqësor.

Megjithatë, gjatë fazës së vlerësimit, Autoriteti Kontraktues ka krijuar standarde të reja të cilat nuk janë bërë pjesë e dokumentacionit të tenderit.

Në vendimin për eliminim dhe në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka bërë një analizë subjektive të përmbajtjes së kurseve, duke konstatuar se ato lidhen me bujqësinë ose me përdorimin e pesticideve dhe, për këtë arsye, nuk i konsideron të pranueshme.

Një vlerësim i tillë tejkalon kompetencat e komisionit vlerësues.

Komisioni nuk është organ profesional për akreditimin ose klasifikimin e programeve trajnuese dhe nuk mund të zëvendësojë institucionet që kanë lëshuar certifikatat duke bërë interpretimin e përmbajtjes së tyre sipas bindjes së vet.

Vetë termi **Integrated Pest Management (IPM)** është koncept ndërkombëtar që nënkupton menaxhimin e integruar të dëmtuesve përmes kombinimit të metodave biologjike, mekanike, fizike dhe kimike, me qëllim kontrollin efektiv të dëmtuesve duke minimizuar ndikimin në shëndetin e njeriut dhe mjedis.

Ky koncept përdoret në shumë sektorë, përfshirë:

- shërbimet profesionale D.D.D.;

- objektet publike;
- industrinë ushqimore;
- sektorin shëndetësor;
- sektorin bujqësor;
- magazinat;
- objektet industriale.

Prandaj, fakti që një program trajnues përfshin shembuj ose aplikime nga fusha e bujqësisë nuk e zhvesh atë nga karakteri i tij si trajnim për **Integrated Pest Management**.

Përkundrazi, ai mbetet trajnim për IPM, pikërisht ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar asnjë dispozitë të Dosjes së Tenderit që ndalon pranimin e certifikatave të këtij lloji dhe nuk ka sjellë asnjë ekspertizë profesionale që do të provonte se certifikatat e paraqitura nuk trajtojnë menaxhimin e integruar të dëmtuesve.

Në mungesë të një kërkesë të tillë në dokumentacionin e tenderit, Autoriteti Kontraktues nuk mund të ndryshojë kriteret pas hapjes së ofertave dhe të kërkojë që certifikatat të kenë një përmbajtje specifike ose të jenë të orientuara vetëm në një sektor të caktuar.

Një veprim i tillë bie ndesh me nenin 40.12 dhe nenin 45.24 të Rregullores për Prokurimin Publik, sipas të cilave operatori ekonomik nuk mund të eliminohet mbi bazën e një kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës ose në Dosjen e Tenderit.

Për më tepër, nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur dyshime lidhur me vlefshmërinë ose përmbajtjen e certifikatave të paraqitura, ai ka qenë i obliguar që, në pajtim me nenin 72 të LPP-së dhe nenin 40.8 të Rregullores për Prokurimin Publik, të kërkonte sqarime ose të verifikonte informacionin pranë institucioneve që kanë lëshuar certifikatat, e jo të nxirrte përfundime subjektive pa bazë profesionale.

Për rrjedhojë, pretendimi i Autoritetit Kontraktues është i pabazuar në kërkesat e Dosjes së Tenderit, nuk mbështetet në ndonjë dispozitë ligjore dhe nuk mund të përdoret si bazë ligjore për eliminimin e ofertës së GOE.

***Lidhur me pretendimin se GOE nuk ka dëshmuar dy (2) teknike të avancuar në kontrollin dhe menaxhimin e dëmtuesve në shërbim të D.D.D.***

Autoriteti Kontraktues ka pretenduar se GOE nuk e ka përmbushur kriterin për dy (2) teknike të avancuar në kontrollin dhe menaxhimin e dëmtuesve në shërbim të D.D.D., me arsyetimin se certifikatat e paraqitura nuk përmbajnë mekanizëm verifikimi, janë ndjekur online, nuk kanë kredi akademike ose janë lëshuar pak ditë para afatit të dorëzimit të ofertave.

Ky pretendim është plotësisht i pabazuar dhe përbën një interpretim arbitrar të dokumentacionit të tenderit.

Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kërkuar vetëm:

**"Dy (2) teknikë të avancuar në kontrollin dhe menaxhimin e dëmtuesve në shërbim të D.D.D."**

Ndërsa si dëshmi dokumentare ka kërkuar vetëm:

- diplomë ose certifikatë;
- kontratë pune ose marrëveshje për projekt.

Në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit nuk është kërkuar që certifikatat:

- të jenë të lëshuara vetëm nga institucione të akredituara;
- të kenë QR Code;
- të kenë link elektronik për verifikim;
- të kenë numër unik identifikues;
- të jenë me kredi akademike;
- të mos jenë të fituara përmes platformave online;
- të jenë lëshuar para një periudhe të caktuar kohore.

Përkundrazi, Autoriteti Kontraktues ka zgjedhur të vlerësojë dokumentacionin sipas kriterëve që nuk janë bërë pjesë e Dosjes së Tenderit.

Pretendimi se një certifikatë është ndjekur online ose nuk ka kredi akademike nuk ka asnjë relevancë juridike, përderisa një kërkesë e tillë nuk është përcaktuar në dokumentacionin e tenderit.

Po ashtu, pretendimi se certifikata është lëshuar pak ditë para afatit të ofertimit është plotësisht i parëndësishëm nga aspekti juridik. Ligji dhe Dosja e Tenderit nuk përmbajnë asnjë kufizim lidhur me kohën e fitimit të një certifikate, përderisa ajo është e vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertës.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të krijojë kriterë të reja mbi bazën e kohës së lëshimit të një certifikate, pasi një qasje e tillë cenon rëndë parimin e trajtimit të barabartë dhe sigurisë juridike.

Për më tepër, në rast se Autoriteti Kontraktues ka pasur dyshime lidhur me autenticitetin ose vlefshmërinë e certifikatave të paraqitura, ai ka qenë i obliguar të veprojë në pajtim me nenin 72 të LPP-së dhe nenin 40.8 të Rregullores për Prokurimin Publik, duke kërkuar sqarime ose duke verifikuar dokumentacionin pranë institucioneve që i kanë lëshuar ato.

Në vend të kësaj, Autoriteti Kontraktues ka zgjedhur të nxjerrë përfundime subjektive pa kryer asnjë verifikim dhe pa u mbështetur në ndonjë dispozitë ligjore ose kriter të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Një qasje e tillë bie drejtpërdrejt në kundërshtim me nenin 40.12 dhe nenin 45.24 të

Rregullores për Prokurimin Publik, sipas të cilave një operator ekonomik nuk mund të eliminohet mbi bazën e një kriteri që nuk është specifikuar në dokumentacionin e tenderit.

Për rrjedhojë, pretendimi i Autoritetit Kontraktues në këtë pikë është i pabazuar dhe nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për eliminimin e ofertës së GOE.

### ***Lidhur me pretendimin se certifikata për kalibrimin e pajisjeve nuk është e pranueshme***

Autoriteti Kontraktues ka pretenduar se certifikata e paraqitur për z. Sami Pacolli nuk është e pranueshme, me arsyetimin se në të nuk figuron data e lëshimit, mungon QR Code, mungon numri identifikues dhe nuk ekziston mundësia e verifikimit elektronik.

Ky pretendim nuk mbështetet në kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe përbën një interpretim të ri të kriterëve pas hapjes së ofertave.

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar vetëm:

**"Një (1) punëtor i certifikuar për kalibrimin e pajisjeve në shërbim të D.D.D."**

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar:

- diplomë ose certifikatë;
- kontratë pune ose marrëveshje për projekt.

Asnjë dispozitë e Dosjes së Tenderit nuk kërkon që certifikata të përmbajë:

- QR Code;
- kod elektronik verifikimi;
- numër identifikues;
- datë të caktuar lëshimi;
- mekanizëm online verifikimi.

Prandaj, Autoriteti Kontraktues nuk mund të refuzojë një dokument për mungesën e elementeve që nuk janë kërkuar në dokumentacionin e tenderit.

Duhet theksuar se certifikata e paraqitur është lëshuar në vitin 2021, periudhë në të cilën shumë institucione trajnuese nuk përdornin ende sisteme elektronike të verifikimit, QR Code apo identifikues unikë.

Mungesa e këtyre elementeve nuk përbën në vetvete provë se dokumenti është i pavlefshëm apo joautentik.

Në rast se Autoriteti Kontraktues ka pasur dyshime për autenticitetin e dokumentit, ai nuk ka qenë i autorizuar të konkludojë vetë se dokumenti nuk është i besueshëm. Përkundrazi,

në pajtim me nenin 72 të LPP-së dhe nenin 40.8 të Rregullores për Prokurimin Publik, ai ka pasur detyrimin të kërkojë sqarime ose të verifikojë certifikatën pranë institucionit që e ka lëshuar.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë një veprim të tillë, por ka zgjedhur të eliminojë ofertën vetëm mbi bazën e supozimeve të veta.

Një qasje e tillë cenon rëndë parimin e proporcionalitetit, transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe bie në kundërshtim me nenin 40.12 dhe nenin 45.24 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Për më tepër, Dosja e Tenderit nuk ka kërkuar një format të caktuar të certifikatës, por vetëm ekzistencën e saj. GOE ka dorëzuar certifikatën e kërkuar dhe për këtë arsye kriteri konsiderohet i përmbushur.

Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i Autoritetit Kontraktues është i pabazuar dhe nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për eliminimin e ofertës.

### ***Lidhur me pretendimin se i njëjti person nuk mund të paraqitet në më shumë se një pozitë profesionale***

Autoriteti Kontraktues ka pretenduar se GOE nuk e plotëson numrin e stafit profesional, me arsyetimin se z. Sami Pacolli është paraqitur në tri pozita, ndërsa z. Arbër Delijaj në dy pozita, dhe për këtë arsye ka konstatuar se GOE nuk disponon numrin e kërkuar prej njëmbëdhjetë (11) punëtorëve profesionalë.

Ky pretendim nuk ka asnjë bazë në Dosjen e Tenderit, në Ligjin për Prokurimin Publik dhe as në Rregulloren për Prokurimin Publik.

Në Dosjen e Tenderit Autoriteti Kontraktues ka kërkuar:

- një (1) epidemiolog;
- një (1) Bachelor i Mjekësisë Sanitare;
- një (1) teknik sanitar;
- pesë (5) teknikë të trajnuar në Menaxhimin e Integruar të Dëmtuesve (IPM);
- dy (2) teknikë të avancuar në kontrollin dhe menaxhimin e dëmtuesve;
- një (1) punëtor të certifikuar për kalibrimin e pajisjeve.

Në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit nuk është përcaktuar se një person nuk mund të paraqitet në më shumë se një pozitë, nëse ai i plotëson kualifikimet për secilën prej tyre.

Po ashtu, nuk ekziston asnjë dispozitë në Dosjen e Tenderit që kërkon që secila pozitë të mbulohet nga persona të ndryshëm.

Autoriteti Kontraktues, vetëm gjatë fazës së vlerësimit, ka krijuar një kriter të ri sipas të

cilit një person mund të përdoret vetëm për një pozitë.

Një interpretim i tillë është në kundërshtim me parimin e transparencës dhe sigurisë juridike, pasi ndryshon rregullat e garës pas hapjes së ofertave.

Duhet theksuar se kërkesat e Dosjes së Tenderit kanë të bëjnë me ekzistimin e kompetencave profesionale dhe jo me ekskluzivitetin e stafit.

Nëse një punonjës posedon disa certifikime profesionale dhe i plotëson kërkesat për më shumë se një pozitë, nuk ekziston asnjë ndalim ligjor që ai të paraqitet në secilën prej tyre.

Në praktikën profesionale të operatorëve ekonomikë që ushtrojnë veprimtari në fushën D.D.D., është krejtësisht normale që një profesionist të posedojë disa certifikime të ndryshme dhe të kryejë disa funksione teknike njëkohësisht.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues nuk ka dëshmuar se ekziston ndonjë pamundësi faktike ose ligjore që një person të ushtrojë më shumë se një funksion profesional gjatë realizimit të kontratës.

Në mungesë të një ndalimi të tillë në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur të drejtë të imponojë një kufizim të ri pas hapjes së ofertave.

Ky veprim bie ndesh drejtpërdrejt me nenin 40.12 dhe nenin 45.24 të Rregullores për Prokurimin Publik, sipas të cilave operatori ekonomik nuk mund të eliminohet mbi bazën e një kriteri që nuk është përcaktuar në njoftimin për kontratë ose në Dosjen e Tenderit.

Për rrjedhojë, konstatimi i Autoritetit Kontraktues se GOE nuk disponon numrin e kërkuar të stafit profesional është rezultat i një kriteri të shpikur gjatë fazës së vlerësimit dhe nuk mbështetet në asnjë dispozitë të dokumentacionit të tenderit apo të legjislacionit për prokurim publik.

Prandaj, edhe ky pretendim duhet të refuzohet si i pabazuar.

### ***Lidhur me pretendimet e Autoritetit Kontraktues për mosplotësimin e kërkesave lidhur me pajisjet teknike***

Autoriteti Kontraktues ka pretenduar se GOE nuk i posedon ose nuk i ka dëshmuar pajisjet teknike të kërkuara sipas pikës 3 të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale.

Ky konstatim është i pabazuar, pasi nuk mbështetet në kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe nuk merr parasysh dokumentacionin e dorëzuar nga GOE.

Në Dosjen e Tenderit është përcaktuar qartë se:

"Shërbimet e Dezinfektimit hapësinor dhe DDD duhet të dokumentohen me kopje të dokumentit të tyre të pronësisë ose DUD doganore, ose faturë blerjeje ose marrëveshje qiraje."

Pra vetë Autoriteti Kontraktues ka lejuar katër forma alternative të dëshmimit:

- dokument pronësie;
- DUD doganore;
- faturë blerjeje;
- marrëveshje qiraje.

Për rrjedhojë, mjafton ekzistimi i njëres prej këtyre dëshmive që kërkesa të konsiderohet e përmbushur.

Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur të drejtë që gjatë fazës së vlerësimit të kërkojë dokumente shtesë që nuk janë kërkuar në Dosjen e Tenderit.

---

## **Nënpretendimi VII.1**

### **Pajisja e blerë nga kompania "Ekologjia"**

Autoriteti Kontraktues pretendon se OE Jusuf Berisha B.I. ka paraqitur faturë për pajisjen, por nuk ka paraqitur dëshmi të pagesës së saj.

Ky konstatim është i pabazuar.

Në Dosjen e Tenderit nuk është kërkuar në asnjë moment dëshmi e pagesës së faturës.

Përkundrazi, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar vetëm:

"faturë blerjeje"

dhe jo:

"faturë e paguar" apo "dëshmi bankare e pagesës".

GOE ka dorëzuar faturën përkatëse të blerjes, të nënshkruar dhe të vulosur nga palët.

Për më tepër, fatura është lëshuar në vitin 2021, periudhë në të cilën legjislacioni në fuqi lejonte kryerjen e pagesave me para të gatshme deri në kufijtë e lejuar ligjorë.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk mund të kërkojë një dokument që nuk është kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe as të eliminojë operatorin ekonomik mbi bazën e mungesës së një dokumenti që nuk ka qenë pjesë e kërkesave të tenderit.

Një veprim i tillë bie ndesh me nenin 40.12 dhe nenin 45.24 të Rregullores për Prokurimin

Publik.

---

## **Nënpretendimi VII.2**

### **Motorpompa – Gjenerator ULV Absolut Elektrostatik për mjegullim të ftohtë dhe thermofog**

Autoriteti Kontraktues pretendon se GOE nuk e posedon pajisjen e kërkuar.

Ky pretendim është faktikisht i pasaktë.

GOE ka dorëzuar faturën përkatëse të blerjes së pajisjes, dokumentacionin mbështetës dhe fotografitë e saj.

Përveç kësaj, anëtari tjetër i GOE ka paraqitur edhe marrëveshjen e qirasë për pajisje të kësaj natyre, në përputhje të plotë me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar asnjë mangësi konkrete në dokumentacionin e dorëzuar, por është kufizuar në një konstatim të përgjithshëm se pajisja nuk është dëshmuar.

Një arsyetim i tillë nuk përmbush standardin minimal të arsyetimit administrativ dhe nuk i mundëson operatorit ekonomik të kuptojë se cila dëshmi konsiderohet e pamjaftueshme.

---

## **Nënpretendimi VII.3**

### **Elektropompa ULV tërësisht elektrike e montuar në kamionetë**

Autoriteti Kontraktues pretendon se GOE nuk ka paraqitur dëshmi për këtë pajisje.

Ky pretendim nuk qëndron.

GOE ka dorëzuar marrëveshjen e qirasë me kompaninë Slavisan DDD d.o.o., ndërsa pajisja figuron në regjistrin e aseteve fikse të kësaj kompanie.

Pajisja është identifikuar qartë në listën e dorëzuar dhe janë bashkëngjitur edhe fotografitë përkatëse.

Për më tepër, Dosja e Tenderit nuk ka kërkuar ndonjë formë shtesë dëshmimi përtej dokumenteve të pronësisë, DUD-it, faturës ose marrëveshjes së qirasë.

GOE ka përmbushur pikërisht atë që është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

---

## **Nënpretendimi VII.4**

### **Pesë motorpompa LV-ULV dyfunktionale**

Autoriteti Kontraktues pretendon se në marrëveshjen e qirasë me kompaninë Slavisan DDD nuk është specifikuar saktësisht se cilat pajisje janë dhënë me qira.

Ky pretendim është i pabazuar.

GOE ka dorëzuar marrëveshjen e qirasë dhe regjistrin e aseteve fikse të qiradhënësit.

Në regjistrin e dorëzuar figurojnë pajisjet përkatëse me numrat inventarë përkatës dhe identifikohen qartë si pajisje të llojit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Në rast se Autoriteti Kontraktues ka pasur paqartësi lidhur me identifikimin e pajisjeve, ai ka qenë i obliguar të kërkonte sqarime sipas nenit 72 të LPP-së dhe nenit 40.8 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Në vend të kësaj, ka zgjedhur të eliminojë ofertën pa kërkuar asnjë sqarim.

Një qasje e tillë bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe me praktikën e konsoliduar të OSHP-së.

---

## **Nënpretendimi VII.5**

### **Pajisja për trajtimin e pusetave**

Autoriteti Kontraktues pretendon se GOE nuk e posedon pajisjen e kërkuar.

Edhe ky pretendim nuk qëndron.

GOE ka paraqitur marrëveshjen e qirasë me kompaninë Slavisan DDD d.o.o., ndërsa pajisja figuron në regjistrin e aseteve fikse të kësaj kompanie.

Pajisja është identifikuar me emërtimin teknik përkatës dhe dokumentacioni mbështetës është dorëzuar në ofertë.

Për më tepër, Dosja e Tenderit nuk ka kërkuar ndonjë formë shtesë të dëshmimit përtej dokumenteve të përcaktuara në kërkesat teknike.

Prandaj, pretendimi i Autoritetit Kontraktues nuk mbështetet në dokumentacionin e

tenderit.

---

## **Nënpretendimi VII.6**

### **Katër Power Sprayer me kapacitet minimum 500 litra**

Autoriteti Kontraktues pretendon se qiradhënësi nuk ka paraqitur faturë ose DUD doganore për pajisjet e lëshuara me qira.

Ky pretendim është në kundërshtim me vetë kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar alternativisht:

dokument pronësie, DUD, faturë ose marrëveshje qiraje.

GOE ka paraqitur marrëveshjen e qirasë.

Me paraqitjen e marrëveshjes së qirasë, kërkesa është përmbushur plotësisht.

Në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit nuk është kërkuar që qiradhënësi të paraqesë njëkohësisht edhe DUD-in, edhe faturën, edhe dokumente shtesë të pronësisë.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të shtojë kërkesa të reja pas hapjes së ofertave.

Për rrjedhojë, eliminimi mbi këtë bazë është i kundërligjshëm.

### ***Lidhur me pretendimin se metodologjia e paraqitur nuk është vetëm për dezinfektimin hapësinor dhe se preparatet nuk i plotësojnë kërkesat e Aneksit 1***

Autoriteti Kontraktues ka pretenduar se GOE ka paraqitur një metodologji të përgjithshme për të gjitha shërbimet, ndërsa sipas tij është kërkuar metodologji vetëm për dezinfektimin hapësinor. Po ashtu, AK ka pretenduar se preparatet e paraqitura nga kompania Slavisan DDD d.o.o. vlejné vetëm për territorin e Malit të Zi, se nuk ekziston marrëveshje për blerjen ose shfrytëzimin e tyre dhe se disa Certifikata të Analizës (COA) janë të skaduara.

Asnjëri prej këtyre pretendimeve nuk mbështetet në Dosjen e Tenderit.

Sa i përket metodologjisë, GOE ka dorëzuar metodologji të detajuar për të gjitha shërbimet objekt të kontratës, duke përfshirë edhe metodologjinë për dezinfektimin hapësinor të ndarë në faza. Pra, kërkesa e Autoritetit Kontraktues jo vetëm që është përmbushur, por është tejkaluar, pasi janë përshkruar edhe aktivitetet tjera të kontratës.

Fakti që operatori ekonomik ka paraqitur metodologji më të gjerë nuk mund të shërbejë si arsye për eliminim, përderisa metodologjia për dezinfektimin hapësinor ekziston dhe është pjesë e dokumentacionit të ofertës.

Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar se cila pjesë konkrete e metodologjisë mungon apo cili element i kërkuar nuk është përmbushur, por është kufizuar në një konstatim të përgjithshëm, pa analizuar dokumentacionin e dorëzuar.

Për më tepër, pretendimi se preparatet e paraqitura nga Slavisan DDD d.o.o. vlejné vetëm për territorin e Malit të Zi nuk ka asnjë bazë në Dosjen e Tenderit.

Në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit nuk është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë:

- marrëveshje për furnizim me preparate;
- kontratë për blerjen e preparateve;
- autorizim nga prodhuesi;
- marrëveshje me distributorin;
- leje importi për produktet biocide;
- dëshmi se preparatet janë regjistruar në Republikën e Kosovës në momentin e ofertimit.

Kërkesa e vetme e Autoritetit Kontraktues ka qenë që operatori ekonomik të paraqesë dokumentacionin teknik për preparatet dhe të dëshmojë se ato korrespondojnë me përbërjet aktive të kërkuara në Aneksin 1.

GOE ka dorëzuar:

- Safety Data Sheet (SDS);
- Certificate of Analysis (COA);
- dokumentacion teknik për secilin preparat;
- dokumentacion mbi përbërjen dhe substancat aktive.

Madje, dokumentacioni i paraqitur nga GOE tejkalon kërkesat minimale të Dosjes së Tenderit.

Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar asnjë preparat që nuk i plotëson përbërjet aktive të kërkuara sipas Aneksit 1, por është ndalur vetëm në faktin se dokumentacioni është lëshuar nga autoritetet kompetente të Malit të Zi.

Ky fakt nuk përbën asnjë bazë ligjore për eliminim, pasi Dosja e Tenderit nuk ka vendosur një kufizim të tillë.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të krijojë kritere të reja pas hapjes së ofertave duke

kërkuar kushte që nuk janë bërë pjesë e dokumentacionit të tenderit.

Po ashtu, pretendimi se nuk ekziston marrëveshje ndërmjet GOE dhe Slavisan DDD d.o.o. për përdorimin ose furnizimin me preparate është plotësisht jashtë kërkesave të tenderit.

Një kërkesë e tillë nuk ekziston askund në Dosjen e Tenderit.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se një dokument i tillë është i domosdoshëm, ai ka qenë i obliguar ta përfshinte si kriter kualifikues në dokumentacionin e tenderit, e jo ta kërkojë vetëm gjatë fazës së vlerësimit.

Veprimi i Autoritetit Kontraktues bie ndesh drejtpërdrejt me nenin 40.12 dhe nenin 45.24 të Rregullores për Prokurimin Publik, sipas të cilave operatori ekonomik nuk mund të eliminohet mbi bazën e një kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin për kontratë ose në Dosjen e Tenderit.

Sa i përket pretendimit se disa Certifikata të Analizës (Certificate of Analysis – COA) janë të skaduara, edhe ky pretendim është juridikisht i pabazuar.

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar vetëm paraqitja e Certifikatës së Analizës për secilin preparat.

Në asnjë pjesë të dokumentacionit të tenderit nuk është përcaktuar:

- afati maksimal i vlefshmërisë së Certifikatës së Analizës;
- periudha brenda së cilës ajo duhet të jetë lëshuar;
- apo ndonjë kriter tjetër lidhur me datën e saj.

Certifikata e Analizës nuk është licencë, autorizim apo leje administrative që skadon me kalimin e kohës.

Ajo është dokument laboratorik që dëshmon analizën dhe karakteristikat teknike të produktit në momentin e prodhimit ose testimit.

Përderisa përbërja, substancat aktive dhe formulimi i produktit nuk kanë ndryshuar, Certifikata e Analizës mbetet dokument teknik valid për qëllimet e tenderit.

Për më tepër, GOE ka dorëzuar Certifikatat e Analizës pikërisht ashtu siç janë kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të shtojë një kriter të ri lidhur me afatin e vlefshmërisë së COA-ve, pasi një kërkesë e tillë nuk ka ekzistuar në dokumentacionin e tenderit.

Për rrjedhojë, edhe ky pretendim është në kundërshtim me nenin 40.12 dhe nenin 45.24 të Rregullores për Prokurimin Publik dhe nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për eliminimin e ofertës së GOE.

Duke u bazuar në të gjitha faktet, provat dhe argumentet e paraqitura në këtë ankesë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:

1. Ta aprovojë si të bazuar këtë ankesë.
2. Ta anulojë Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, si dhe vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.
3. Të konstatojë se Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar ofertat në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, Rregulloren për Prokurimin Publik dhe me kërkesat e Dosjes së Tenderit.
4. Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që të bëjë rivlerësimin e ofertave në përputhje me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, pa aplikuar kritere shtesë që nuk janë bërë pjesë e dokumentacionit të tenderit.
5. Duke pasur parasysh natyrën shumë teknike të pretendimeve të Autoritetit Kontraktues, të emërojë një ekspert të pavarur të fushës së Dezinsektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit (DDD), i cili do të vlerësojë në mënyrë profesionale dokumentacionin teknik të paraqitur nga palët.
6. Të obligojë Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit të respektojë parimet e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës efektive, të garantuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

*g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Shërbimet e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit të objekteve, institucioneve dhe hapësirave publike në Komunën e Graçanicës**

**Njoftimi për kontratë 30.04.2026 00:00**

**Data e hapjes së tenderëve 08.06.2026 13:00**

**Vendimi 17.06.2026**

**Kerkesa për rishqyrtim 22.06.2026 15:09**

**Vendim mbu refuimin e kërkesës 25.06.2026 13:11**

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

**Kerkesa për rishqyrtim**

### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit,

*dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

neni 1 i LPP-së (qëllimi i ligjit);  
neni 7 i LPP-së (trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi)  
;neni 56 i LPP-së;  
neni 59 i LPP-së;  
neni 69 i LPP-së;  
neni 72 i LPP-së;  
neni 26.5 i Rregullores për Prokurimin Publik

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

### **Mundesia e Shperblimit me kontrate**

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*

*g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*